

URDHËR I PËRBASHKËT

Nr. 418 datë 30.7.2019

PËR PËRCAKTIMIN E SHËRBIMEVE TË OFRUARA ME ÇMIME TË REDUKTUARA PËRMES PËRDORIMIT TË KARTËS SË STUDENTIT NË FUSHËN E ARTIT DHE KULTURËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe pikës 2, të vendimit nr. 226, datë 17.4.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kategoritë e shërbimeve të ofruara nga entet shtetëror edhe subjekte të tjera, të cilat përfitohen me çmime të reduktuara përmes përdorimit të kartës së studentit”,

URDHËROJMË:

1. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në masën pesëdhjetë për qind (50%), në sistemin tarifar për aksesin në fushën e institucioneve të artit dhe kulturës sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Përfituesit e kartës së studentit përfitojnë shërbime me çmime të reduktuara në masën shtatëdhjetë për qind (70%) në sistemin tarifar për aksesin në muze publikë në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, parqet kombëtare arkeologjike dhe monumentet e kulturës sipas lidhjes nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri.

3. Shërbimet e ofruara nga institucionet e trashëgimisë kulturore për aksesin në muze publikë në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore, parqet kombëtare arkeologjike dhe monumentet e kulturës, për studentët të organizuar në ekspedita mësimore dhe leksione të hapura, janë me tarifë zero.

4. Shërbimet e ofruara në kuadër të edukimit artistik përmes artit, kulturës dhe turizmit kulturor në skena dhe ambiente të hapura, nga institucionet e artit dhe trashëgimisë kulturore janë me tarifë zero.

5. Efektet financiare nga reduktimi i çmimeve përballohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Kulturës dhe institucionet publike të artit dhe kulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I KULTURËS

Elva Margariti

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Besa Shahini

LIDHJA NR.1

1. Shfaqje me çmime të reduktuara në masën pesëdhjetë për qind (50%) në sistemin tarifar të biletave në institucionet të artit si vijon:

- a) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor;
- b) Teatri Kombëtar;
- c) Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”;
- d) Cirku Kombëtar;
- e) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave.

12. Fotokopje dhe skanime në masën pesëdhjetë për qind (50%) të tarifave të miratuara në Bibliotekën Kombëtare.

3. Temat studimore, në masën pesëdhjetë për qind (50%) të tarifave të miratuara në Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit.

LIDHJA NR.2

1. Vizita me çmime të reduktuara në masën shtatëdhjetë për qind (70%) në sistemin tarifor të biletave në muze publikë, parqet kombëtare arkeologjike dhe monumentet e kulturës si vijon:

- a) Muzeu Historik Kombëtar;
- b) Galeria Kombëtare e Arteve;
- c) Qendra Muzeore Krujë – “Muzeu Kombëtar Skënderbeu, Muzeu Etnografik Krujë”;
- d) Qendra Muzeore Berat – “Muzeu i Ikonografisë Onufri, Muzeu Etnografik Berat”;
- e) Qendra Muzeore Durrës – “Muzeu Kombëtar Arkeologjik, Parku Arkeologjik”;
- f) Muzeu Kombëtar i Artit Mesjetar Korçë, Muzeu Arkeologjik, Korçë, Muzeu i Arsimit, Korçë;
- g) Muzeu Kombëtar i Përgjimeve “Shtëpia me gjethe”;
- h) Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi, Shkodër;
- i) Muzeu Kombëtar i Pavarësisë, Vlorë;
- j) Parku Kombëtar Arkeologjik, Apoloni;
- k) Parku Kombëtar Arkeologjik, Bylis;
- l) Parku Kombëtar i Butrintit;
- m) Parku Kombëtar Arkeologjik , Kalaja Shkodër;
- n) Parku Kombëtar Arkeologjik, Amantia;
- o) Parku Kombëtar Arkeologjik, Orikum;
- p) Parku Kombëtar Arkeologjik, Finiq;
- q) Parku Kombëtar Arkeologjik, Antigone;
- r) Kalaja Berat;
- s) Kalaja Gjirokastrë;
- t) Kalaja Lezhë;
- u) Kala Porto-Palermo;
- v) Kalaja e Kaninës;
- w) Kalaja e Himarës;
- x) Manastiri i 40 Shenjtorëve;
- y) Manastiri i Mesopotamit.